



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2024

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Gjuhë shqipe dhe letërsi (Gjimnazi dhe gjimnazi gjuhësor)

Varianti B

Shënim: Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdesshëm, sidomos në pyetjet e hapura, që kanë më shumë se një mundësi përgjigjeje dhe ku nxënësit shprehen shpesh, edhe me përgjigje të përafërta.

PJESA I

ATDHEU!

Përgjigjet e sakta për çdo pyetje të testit

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	D	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	D	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë
Pyetja 7	A	1 pikë
Pyetja 8	B	1 pikë
Pyetja 9	D	1 pikë
Pyetja 10	A	1 pikë

Pyetja 11**2 pikë****Model përgjigjeje:**

- Fillimi i mësimit të gjuhës shqipe.
- Ora e dashurisë.
- Komunikimi me nënën e tij.
- Largimi nga atdheu.
- Etj.

2 pikë Nëse nxënësi rendit dy momente nga përvoja e tij.**1 pikë** Nëse nxënësi rendit vetëm një moment nga përvoja e tij.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk e zhvillon pyetjen ose përgjigjet në mënyrë të gabuar.*Shënim: Këtu do të pranohet nga vlerësuesi çdo përgjigje e përafërt me kuptimin e përgjigjes model.***Pyetja 12****2 pikë****Model përgjigjeje:**

- Malli për atdheun.
- Trishtimi që lind nga vitet larg atdheut.
- Krenaria për identitetin e tij.
- Besimi që ka fituar falë nënës së tij.
- Dashuria për gjuhën shqipe.
- Etj.

2 pikë Nëse nxënësi zbulon dhe shkruan dy nga ndjenjat që çojnë në një mendim të sinqertë.**1 pikë** Nëse nxënësi zbulon dhe shkruan njëren nga ndjenjat që çon në një mendim të sinqertë.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose shkruan përgjigje që nuk ka lidhje me pyetjen.*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të përafërt me shembujt më lart, ose çdo ndjenjë të gjetur nga nxënësi, që buron nga teksti "Atdheu".***Pyetja 13****2 pikë****Model Përgjigjeje:****Fjalët kyçe:** Disa prej fjalëve kyçe që përdor djali për të përshkruar atdheun janë: atdheu, malet, problemet, deti, njerëzit, peizazh, të thella, të mundimshme, të dashura, të shtrenjta, nëna ime, etj.**2 pikë** Nëse nxënësi gjen dy prej fjalëve kyçe.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm njëren fjalë kyçe.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk e zhvillon pyetjen ose përgjigjet në mënyrë të gabuar.*Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të nxënësit e konsideruar si fjalë që kanë peshë kuptimore në përshkrimin për atdheun.*

Pyetja 14**2 pikë****Model përgjigjeje:**Gjymtyrët homogjene: **male, rrugë, qytete, peizazhe.**Funksioni: **kundrinor i drejtë.****2 pikë** Nëse nxënësi gjen gjymtyrët homogjene dhe thotë funksionin.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm gjymtyrët homogjene.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.**Pyetja 15****2 pikë****Model përgjigjeje:**Përcaktori: **e përjetuar**Me se është shprehur: **me mbiemër****2 pikë** Nëse nxënësi gjen përcaktorin dhe tregon me se është shprehur.**1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm përcaktorin.**0 pikë** Nëse nxënësi nuk e zhvillon pyetjen ose përgjigjet në mënyrë të gabuar.**Pyetja 16****2 pikë****Model përgjigjeje:****Karakteristikat gjuhësore:**

- **Gjuhë e thjeshtë**, e qartë, e prekshme, e natyrshme, komunikuese me lexuesin, e drejtpërdrejtë, e ngjashme me **ligjërimin bisedor**. (Im bir sot më ka emocionuar, prandaj ndjesinë e përjetuar dua ta ndaj me ju.)
- Gjuhë **rrëfyese, emocionuese**, e gjallë, gjuhë ndikuese te lexuesi. (Nuk e di sa krenar jeni ju për djalin tuaj, por unë jam mjaft krenar që kam patur fatin të jem profesori i tij.)
- Përdorimi i **përshkrimeve të shkurtra** në shërbim të temës. (Atdheu im natyror është një vend ku deti dhe malet bashkëjetojnë aq bukur, ku njerëzit janë të bukur si peizazhi, ku problemet janë të thella si deti.)
- Mbizotërimi i fjalive të përbëra të llojeve të ndryshme. (Unë e kam jetuar pak atdheun tim, kur u largova prej tij, nuk e dija që kthimi tek ai do të shkonte kaq gjatë e unë do të rritesha duke parë të tjera male, rrugë, qytete e të tjera peizazhe, por kurrë aq të dashura e të shtrenjta.)
- Rrëfimi në **vetën e parë**. (**Im bir. E hapa letrën. / Unë jam krenar. / Atdheu im është.**)
- Përdorimi i **ligjëratës së drejtë**. (“Ju profesor ndoshta nuk do ta kuptoni përgjigjen time e jam i sigurt se do t’ju tingëllojë e çuditshme; atdheun për mua, duke qenë unë fizikisht larg tij, e ka zëvendësuar mamaja ime.”)
- Përdorimi i foljeve në **kohën e tashme** dhe në **kohën e shkuar**. (fillonte – koha e pakryer, u përloa – koha e kryer e thjeshtë, (më) ka emocionuar – koha e kryer) ; koha e tashme: është, bën, janë).
- Përdorimi i **ndajfoljeve që japin të dhëna për kohën dhe vendin**. (sot, kurrë, më pas, aty.)

- Përdorimi i **foljeve në formën joveprore dhe në veprore**. (**Folje në joveprore**: ishte emocionuar, do të rritesha, u dëshpërova, zgjohem, jam i sigurt); **Folje në veprore** si: (më) ka emocionuar, bëja, flas, shkruaj.)

2 pikë Nëse nxënësi gjen një të një nga karakteristikat më lart ose të përafërta me to dhe e ilustron me një shembull.

1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm karakteristikën.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të nxënësit, që nuk është si formulimet më lart, por që në një mënyrë tjetër, të çon në veçoritë gjuhësore të tekstit.

Pyetja 17

2 pikë

Model përgjigjeje:

Nëna jep mesazhe të mëdha, reale dhe të vërteta, mesazhe që motivojnë të tjerët.

Fjalët e nënës kanë brenda **shpërblimin për mundin** e saj. Ajo **ndihet krenare** për të birin, ndihet mirë që **ka kryer siç duhet detyrën** e saj. Përcjell **pozitivitet** të natyrshëm dhe në asnjë rast mendjemadhësi, përkundrazi shumë **modesti, thjeshtësi dhe natyrshmëri**. Nëna gjithashtu është e vetëdijshme se asgjë nuk ka qenë e lehtë, por është ndërtuar përmes **sakrificës**.

2 pikë Nëse nxënësi analizon shprehjen duke u mbështetur në përmbajtjen e saj.

1 pikë Nëse nxënësi analizon pjesërisht dhe nuk është plotësisht i qartë, apo nuk e përfundon deri në fund mendimin e tij.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet fare ose shkruan diçka që nuk ka lidhje me pyetjen.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo analizë të bërë nga nxënësi sipas këndvështrimit të tij, por duke u mbështetur në fjalinë referuese.

PJESA II

SHEKSPIR “HAMLETI”

Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	B	1 pikë
Pyetja 20	A	1 pikë
Pyetja 21	A	1 pikë
Pyetja 22	C	1 pikë
Pyetja 23	A	1 pikë
Pyetja 24	D	1 pikë
Pyetja 25	B	1 pikë
Pyetja 26	D	1 pikë
Pyetja 27	B	1 pikë

Pyetja 28 2 pikë**Model përgjigjeje:**

Hamleti përfaqëson idealin humanist të luftës për dinjitet.

Ofelia përfaqëson idealin humanist të njeriut të përsosur.

Klaudi përfaqëson të keqen, hipokrizinë, veset, uzurpimin e fronit. Ai në këtë rast është e kundërta e Hamletit: hipokriti, uzurpuesi, i keqi.

Poloni përfaqëson njeriun besnik dhe servil të mbretit, ambicioz, manipulues.

Përmes tyre Hamleti përcjell këto mesazhe:

Lufta për dinjitet përballë veseve të shoqërisë është e pashmangshme dhe përfundon gjithnjë me fitore.

Njeriu është qenie e bukur dhe me vlera pavarësisht asaj që ofron jeta.

Nuk ka kompromis mes së mirës dhe së keqes, pasi krimi sjell krimin.

E mira duhet përkrahur dhe përhapur dhe e keqja duhet shkukur me rrënjë.

2 pikë	Nëse nxënësi tregon dy nga mesazhet humaniste që burojnë nga vepra.
1 pikë	Nëse nxënësi tregon njërin nga mesazhet humaniste që buron nga vepra.
0 pikë	Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo gjetje mesazhi humanist që buron nga vepra e Shekspirit, pavarësisht formulimit të lirë dhe pikëvështrimit personal nga ana e nxënësit.

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje:

Hamleti kalon me kujdes dhe qetësi në **misionin e tij kryesor**. Ai do të marrë hakun e babait, por ndërkohë do të kujdeset që fronin ta trashëgojë dikush që e meriton dhe mbi të gjitha t'i përcjellë botës **mesazhin e fuqishëm, që idealet humaniste dhe njeriu pozitiv** duhet të triumfojnë mbi veset e shoqërisë.

Hamleti fillimisht ka objektiv **hakmarrjen**, më pas ndërton me kujdes planin e tij duke kapërcyer interesin personal, më pas ndodhin vrasjet, në fund, **porosia që i lë Horacit**.

Gjatë rrugëtimit të tij nga hakmarrja personale në përpjekje për të ndrequr shoqërinë dhe për të vendosur të **vërtetën dhe drejtësinë**, Hamleti **përjeton ndryshime të rëndësishme** në qëllimet dhe veprimet e tij. Fillimisht, ai fokusohet te hakmarrja personale, me kalimin e kohës qëllimet e tij ndryshojnë, ai **përballet me dilema morale dhe etike** në lidhje me këtë detyrë. Hakmarrja **personale shndërrohet në një detyrë** akoma më të madhe : **ndreqjen e shoqërisë**, për të vendosur **të vërtetën dhe drejtësinë**. Hamleti del si gjyqtar që dënon në parim çdo të keqe e padrejtësi.

Në fund të rrugëtimit të tij, Hamleti kupton se drejtësia nuk është gjithmonë e qartë dhe që të arrijë të vërtetën dhe drejtësinë kërkon angazhim të thellë dhe përballje me konflikte morale. Kështu, ndryshimet kryesore në qëllimet dhe veprimet e Hamletit përfshijnë kalimin nga hakmarrja personale drejt një kërkesë më të gjerë për drejtësi dhe vendosje të së vërtetës në shoqëri.

- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon me shembuj si ndryshon Hamleti gjatë rrugës për realizimin e misionit të tij.
1 pikë Nëse nxënësi bën një shpjegim të pjesshëm.
0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të marrë në konsideratë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit me modelin e dhënë, që i referohet rrugës së personazhit Hamlet dhe e shprehur qartë.

Pyetja 30

4 pikë

Model përgjigjeje:

Klaudi përfaqëson **krimin, veset e këqija të shoqërisë, padrejtësinë njerëzore, njeriun që për pushtet bën gjithçka**, njeriun e lig dhe hipokrit.

Vargjet ilustruese:

- Dhe zogjtë që na nxjerr pa fjalë janë
Fort të rrezikshëm; që t'ia presim hovin,
- Vendosëm t'a dërgojmë shpejt n'Angli
Haraçn' e prapambetur të kërkojë;
- Ato që foli, ndonëse pa lidhje,
Nuk ishin marrëzi. Diç ka në shpirt.
- Sikundër thamë, pra, do proceduar,
Se çmendja e të madhit do vëzhguar.

Hamleti **përfaqëson idealet humaniste të Shekspirit, heroin rilindës** me dhunti të shumanshme, me veti intelektuale të jashtëzakonshme, me moral të lartë, të paepur përpara vështirësive që udhëhiqet nga arsyeja dhe jo nga pasioni, **njeriun që lufton për dinjitetin** e tij me të keqen dhe vesin, njeriun **gjakftohtë dhe praktik** që vlerëson më shumë hakmarrjen si kujdes ndaj familjes, sesa fronin dhe trashëgiminë e tij. Hamletit i intereson **të shkulë dhe të dënojë të keqen**, pak rëndësi ka kush e trashëgon fronin.

Vargjet ilustruese:

- I di mjaft mirë fytyrlyerjet tuaja...
- Martohu me ndonjë budalla; se burrat e mençur e dinë fort mirë ç'farë shtaza me brirë po i bëni.

- 4 pikë** Nëse nxënësi shpjegon çfarë përfaqëson secili personazh dhe ilustron me nga një shembull.
- 3 pikë** Nëse nxënësi shpjegon çfarë përfaqësojnë dy personazhet dhe një shembull, ose dy shembujt që të çojnë te të dy rastet dhe shpjegimin për vetëm një personazh.
- 2 pikë** Nëse nxënësi shpjegon se çfarë përfaqësojnë dy personazhet, ose jep vetëm dy shembujt për secilin ose jep vetëm një shembull dhe një shpjegim për njërin personazh.
- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen njërën prej tyre.
- 0 pikë** Nëse nuk përgjigjet fare ose gjen përgjigje të gabuara.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përgjigje të përafërt të nxënësit që është një shpjegim logjik për konfliktin qendror nisur nga dy personazhet Hamlet dhe Klaud dhe shembujt e marrë nga fragmenti ose të perifrastuar.

Pyetja 31

2 pikë

Model përgjigjeje:

Hamleti në këto vargje **ngre gishtin e akuzës ndaj shoqërisë**, e cila nuk i vlerëson siç duhet **vlerat**.

Ky moment mund të konsiderohet dhe **një shprehje e ideve humaniste të njeriut**, përmes pastërtisë, bukurisë dhe vlerave të Ofelisë. Përshkruan pamjen e jashtme, ndërsa reflekton mbi **kompleksitetin e jetës dhe vlerave morale**. Hamleti është njeri egërsisht **praktik, objektiv dhe tepër i qartë**.

Ndonëse Hamleti po **akuzon hapur shoqërinë e kohës**, fjalët e tij janë të zgjedhura, si vlerësim për Ofelinë, krijojnë distancë me të, janë në funksion të planit të tij, të çmendurisë së shtirur.

- 2 pikë** Nëse nxënësi komenton qartë arsyet e shprehjes në atë mënyrë të Hamletit.
- 1 pikë** Nëse nxënësi komenton pjesërisht vargjet.
- 0 pikë** Nëse nxënësi komenton në mënyrë të gabuar jashtë përmbajtjes, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo koment të nxënësit nga këndvështrimi individual, që lidhet me përmbajtjen e pyetjes dhe formulohet bukur e qartë.

Pyetja 29

2 pikë

Model përgjigjeje:

Falët e Hamletit kanë ngarkesë dhe ngjyrim emocional. Njeriu që dikur e donte aq shumë Ofelinë, është “çmendur” dhe po e mallkon atë, i detyruar nga roli që ka marrë përsipër të luajë. Shprehja është paradoksale: të jap pajë, të jap dhuratë, por kjo është dhuratë e tmerrshme, është mallkimi. Pra **efekti** që krijohet është **kontrasti** midis karakterit të ndryshëm të një mallkimi dhe mënyrës së shprehjes së tij si një dëshirë ose kërkesë për të dhënë diçka. Nxënësi në përgjigjen e tij duhet të shpjegojë pikërisht **forcën artistike të pranëvënies së dy fjalëve: pajë – mallkim.**

OSE

Hamleti është personazhi qendror i tragjedisë që **eksploron thellësisht konceptet** e çmendurisë, shpirtërores dhe morales. Të shprehësh një mallkim si dëshirë apo kërkesë në kontekstin e një martese që është një ngjarje e lumtur dhe e gëzueshme, **shënon një kontradiktë** që e **përforcon ndjesinë** e çmendurisë që rrethon Hamletin. Kjo ndihmon në **thellimin e portretit psikologjik** të personazhit.

OSE

Shprehja paraqet një **ndjenjë të thellë zemërimi** dhe **indinjatë** nga ana e Hamletit. Përdorimi i fjalëve të tilla si "mallkim" dhe "pajë" sugjeron një lloj ngjyrimi emocional që lidhet me ndjenjën **e zhgënjimit, tradhtisë** dhe **dëshirës** për të shprehur zemërimin. Kjo shprehje ndihmon të përforcohet **emocioni i tensionit** dhe **konfliktit të brendshëm** të Hamletit, duke shfaqur një kombinim të indinjatës, zhgënjimit, dhe dëshirës për t'u përballur me tradhtinë. Ky ngjyrim emocional **është i fortë dhe i thellë**, i ngjashëm me një ndjesi të fortë zemërimi.

2 pikë Nëse nxënësi shkon me përgjigje te thelbi kontradiktor i shprehjes dhe e shpreh atë qartë.

1 pikë Nëse nxënësi jep përgjigje të përafërt, por jo të plotë.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet në mënyrë të gabuar ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të marrë në konsideratë përgjigjen e nxënësit nga çdo këndvështrim i tij, por duke e çuar përgjigjen tek efekti dhe ngjyrimi emocional i shprehjes.

Pyetja 33

2 pikë

Model përgjigjeje:

Apostrofi:

- O perëndi e kij nën kujdes.
- O engjëj të qiellit, silleni prapë ndër mënt.

Funksioni: Synon **të theksojë, të veçojë** një detaj, ta bëjë atë të dukshëm, t'i japë **rëndësi** situatës, asaj që po ndodh, të **tërheqë vëmendjen** e lexuesit dhe spektatorit, është **element i fortë skenik**. E bën **situatën tragjike**. Përdorimi i apostrofit në këtë rast paraqet **një thirrje** për ndihmë ose mbështetje, duke reflektuar më tej krizën shpirtërore të Ofelisë dhe gjendjen e saj të brishtë pas ngjarjeve të ndodhura.

2 pikë Nëse nxënësi gjen një apostrof dhe thotë pse është përdorur.

1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm apostrofin.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

Shënim: Komisioni do të vlerësojë me pikë çdo përgjigje të nxënësit, që jep saktë një apostrof nga fragmenti dhe shpjegimin për funksionin e përdorimit të tij.

Pyetja 34**2 pikë****Model përgjigjeje:**

- Gjendja emocionale e mjerë e Ofelisë është **në një pikë kulminante**. Ajo ka arsye të ndihet kështu.
- Shkak i kësaj gjendjeje emocionale është **reagimi i çmendur** i Hamletit. Ajo është **e shokuar, e pafjalë** nga ndryshimi që ka pësuar njeriu që ajo dashuron.
- **Kontrasti i fortë midis asaj që Hamleti ka qenë dhe është bërë, e dërrmon** atë. Kontrasti midis asaj që ka parë dhe po sheh, **është tragjik**.

2 pikë Nëse nxënësi tregon si ndihet Ofelia dhe shpjegon shkakun se nga e ka burimin ajo gjendje emocionale.

1 pikë Nëse nxënësi jep një përgjigje të pjesshme si nga ana e përmbajtjes, ashtu edhe e të shkruarit.

0 pikë Nëse nxënësi nuk përgjigjet ose jep përgjigje të gabuar.

Shënim: Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë pozitivisht çdo mendim të përafërt të nxënësit që na çon në gjendjen e Ofelisë në këtë fragment.

Pyetja 35**2 pikë****Model përgjigjeje:**

- **Ndërrim**
- **Oborrtari**

2 pikë Nëse nxënësi shkruan saktë në gjuhën standarde fjalët.

1 pikë Nëse nxënësi shkruan saktë vetëm njërën nga fjalët.

0 pikë Nëse nxënësi përgjigjet gabim, ose nuk përgjigjet fare.

PJESA III**Pyetja 36****8 pikë**

Për pjesën **ese** do të ndiqen në vlerësim kriteret e mëposhtme:

Shtjellimi i idesë**2 pikë**

- shkruan një ese, e cila mbështetet në thënien e Amos OZ, ose në mesazhin e fragmentit joletrar, ose në ngjarje të dëgjua dhe të lexuara, ose në çdo përvojë personale të nxënësit;
- shtjellon përjetime nga ngjarje të cilat i kanë ndikuar në jetën;
- shtjellon ngjarje që i kanë ndryshuar këndvështrimin për botën;
- sjell përfytyrime në formën e historive të krijuara;
- zbërthen bërthamën e kësaj teme të jashtëzakonshme.

Organizimi dhe struktura**2 pikë**

- përdor strukturë të qartë eseje: hyrje – zhvillim – mbyllje;
- siguron kalimin rrjedhshëm në paragrafët zhvillues;
- grupon çështjet në paragrafë të organizuar drejt, qartë, saktë dhe në mënyrë të plotë e të logjikshme;
- zgjedh dhe përdor konektorët e duhur për të siguruar koherencën dhe kohezionin e tekstit. Këta janë të shumëllojshëm dhe i shmangen fjalorit të gjuhës së përditshme;
- përcjell konkluzionin personal në raport me temën (paragrafi përmbyllës).

Stili dhe origjinaliteti**2 pikë**

- përdor një gjuhë të qartë dhe origjinale, për krijimin e një përshtypjeje të plotë për atë që shprehet në raport me temën;
- përdor një gjuhë të pasur me detaje të shumta që mbështetin idenë dhe që ndikojnë dhe vënë në lëvizje imagjinatën e lexuesit;
- përdor gjuhë subjektive dhe shpesh format shpjeguese gërshetohen me detaje përshkruese;
- përdor fjalor të pasur dhe të shumëllojshëm, me shprehje të zgjedhura që sigurojnë origjinalitet në shkrim dhe dëshmojnë për një formim të mirë jo vetëm letrar, por edhe gjuhësor.

Saktësia gjuhësore**2 pikë**

- përdor drejt struktura të fjalive, të cilat mbështetin nga pikëpamja gjuhësore përmbajtjen e esesë;
- shkruan pa gabime fjalë të përdorimeve të shpeshta (ose jo), si dhe ndërton drejt, sipas kuptimit apo kumtimit, të gjitha llojet e fjalive;
- përdor saktë shenjat e pikësimit, të të gjitha llojeve: pikë, presje, dy pika, pikëçuditëse, pikëpyetje, vizë ndarëse etj., gjë që dëshmon për njohje shumë të mirë të rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe;
- shkruan saktë nga pikëpamja e drejtshkrimit, sintaksës e pikësimit, gjë që mbështet në mënyrë të plotë strukturën e fjalive.

Shënim: Në vlerësimin e esesë, rubrikat që do të vlerësohen nuk mund të shihen të palidhura me njëra-tjetrën, pasi ato nuk mund të kenë një mëvetësi të plotë, ato shihen në harmoni. Nga ana tjetër, ky komision do të ketë parasysh, që për rubrikën stili (ku deri më sot janë treguar më të rezervuar) të mbahet në konsideratë që shkruesi i esesë është një nxënës dhe jo një shkrimtar. Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë çdo përpjekje të nxënësit.